



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.120, datë 20.10.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR  
NR. 67 DATË 19.12.2019 “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS  
KANALIZIME FIER SH.A.”

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "*Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "*Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence*" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "*Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

në mbledhjen e datës 20.10.2020 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projekt vendimit për një ndryshim në vendimin e komisionit kombëtar rregullator nr. 67 datë 19.12.2019 “Për licencimin e shoqërisë Ujësajellës Kanalizime Fier sh.a.”,

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësajellës Kanalizime Fier (**UK Fier**) me shkresat nr. 262 prot. datë 30.04.2020 me lëndë “Plotësim Dokumentacioni”, nr. 500 datë 09.07.2020 me lëndë “Plotësim Dokumentacioni” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**), për zgjerimin e zonës së shërbimit, dy Akt Miratime Higjiene Sanitare, në të cilat përfshihen tre njësitë e tjera administrative Topojë, Dermenas dhe Libofsh, që kishin mbetur jashtë zonës së shërbimit të kësaj shoqërie.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të zgjerimit të zonës së shërbimit të UK Fier në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. KKRR ka licencuar shoqërinë UK Fier me vendimin nr. 5, datë 03.02.2017 nr. 67 datë 19.12.2019 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.” me një afat 4 vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe për zonën e shërbimit si më poshtë:

Bashkia Fier:        Njësia Administrative Fier  
Qendër  
Portëz  
Frakull  
Cakran  
Mbrostar  
Levan

4. KKRR në vendimin nr. 67 datë 19.12.2019 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.” i rekomandoi shoqërisë UK Fier që të punonte në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë të të gjithë zonës së shërbimit me akt miratim higjieno – sanitar;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Fier është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

Në pikën 3 të vendimit të KKRR nr. 67 datë 19.12.2019 “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a.”, bëhen këto ndryshime:

*Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Fier sh.a është Bashkia Fier.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**